

NJOFTIM PËR PRIVATËSINË

DHL Express interesohet për privatësinë tuaj.

Misioni ynë është *excellence, simply delivered*, duke siguruar njëkohësisht mbrojtjen tuaj. Ky Njoftim për Privatësinë përshkruan cilat janë të dhënat që ne dhe shoqëritë tona të Deutsche Post DHL Group mbledhin përmes ndërveprimeve tona të ndryshme me ju, për sa kohë i ruajmë ato, ku dhe si i mbledhim ato, te kush i transferojmë dhe cilat janë të drejtat tuaja.



Objekti i këtij Njoftimi për Privatësinë

Ky Njoftim për Privatësinë vlen për të gjithë përdoruesit e shërbimeve, faqeve në internet, aplikacioneve, veçorive apo shërbimeve tona të tjera kudo në botë, nëse ato nuk mbulohen nga një Njoftim i veçantë për Privatësinë.

Ky Njoftim për Privatësinë vlen për kategoritë e mëposhtme të individëve:

- Dërguesit: dërguesit, duke përfshirë punonjësit e tyre, ose individët që dërgojnë një dërgesë
- Marrësit e dërgesave: çdo individ që merr një dërgesë
- Personat që shfaqin interes për ne dhe shërbimet tona ose që paguajnë për to
- Partnerët e biznesit: partnerët e biznesit, duke përfshirë punonjësit e tyre
- Kandidatët për punësim: individët që aplikojnë për një vend pune pranë nesh

Të gjitha subjekteve të mësipërme u referohemi me “ju” ose “i/e juaji/a”.

Praktikat tona të mbrojtjes së të dhënave i nënshtrohen legjislacionit në fuqi në vendet ku ne operojmë. Kjo do të thotë se ne përfshihemi në praktikatat e përshkruara në këtë Njoftim për Privatësinë në një shtet të caktuar vetëm nëse kjo lejohet nga ligjet rajonale ose vendase për mbrojtjen e të dhënave.



Ndryshimet në këtë Njoftim për Privatësinë

Ne rezervojmë të drejtën për ta ndryshuar këtë Njoftim për Privatësinë në mënyrë të herëpashershme, në përputhje me ndryshimet që pësojnë shërbimet tona, përpunimi i të dhënave të tuaja ose legjislacioni në fuqi. Për këtë arsye, ju rekomandojmë t'i riktheheni vazhdimisht Njoftimit tonë për Privatësinë.



Kush është përgjegjës

Personi juridik që vepron si kontrollues i të dhënave tuaja përcakton mënyrën dhe arsyen e përpunimit të të dhënave tuaja:

Për DHL Express Albania

DHL International (Albania)Shpk
Autostrada Tiranë - Durrës km8
Tiranë, 1051
Shqipëri

Për DHL Express Global

DHL International GmbH
Charles-de-Gaulle-Str. 20
53113 Bonn
Gjermani

[Na kontaktoni](#)



Llojet e të dhënave që ne përpunojmë

Ne përpunojmë vetëm të dhënat tuaja që nevojiten për një qëllim specifik. Në disa vende, mund të përpunohen edhe të dhëna të tjera në përputhje me legjislacionin lokal.



Të dhënat e kontaktit

Informacioni përmes të cilit mund t'ju kontaktojmë, p.sh. kur tërheqim ose dorëzojmë një pako.

P.sh.: emri juaj, numri i telefonit, adresa, adresa e emailit



Të dhënat e administrimit të kandidatëve për punësim

Informacioni i përdorur në sistemet e burimeve njerëzore për të dhënat e kandidatëve.

Shembuj: aplikimi juaj, kompetencat, viza e punës



Vërtetimi dhe autorizimi i përdoruesit

Informacioni për identifikimin dhe verifikimin tuaj si përdorues i sistemeve tona dhe për verifikimin e aksesit tuaj në të dhëna specifike, p.sh. aplikimi për dorëzim sipas kërkesës do të shfaqë dërgesat tuaja në pritje.

Shembuj: ID-ja e identifikimit, fjalëkalimi juaj



Të dhënat e profilit

Informacioni mbi profilin tuaj në DHL, p.sh. për përcaktimin e preferencave tuaja të dorëzimit.

Shembuj: preferencat tuaja të dorëzimit, historiku i porosive/blerjeve



Të dhënat e kontaktit

Informacioni i parashtruar dhe i dakordësuar në kontrata, p.sh. palët kontraktuese.

Shembuj: aktiviteti në kontratë, emrat e palëve



Të dhënat e dërgesës

Informacioni që mundëson tërheqjen dhe dorëzimin e dërgesës suaj, p.sh. statusi i dërgesës suaj.

Shembuj: adresa juaj, dokumentet e dërgesës, prova e dorëzimit



Të dhënat financiare

Informacioni i përdorur për faturimin, proceset financiare dhe proceset e pagesës, p.sh. numri i llogarisë bankare që përdoret për pagesat.

Shembuj: llogaria juaj bankare, të dhënat e pagesave elektronike



Të dhënat e identifikimit

Informacioni që përdoret për identifikimin tuaj, p.sh. fotoja e pasaportës për verifikimin e identitetit tuaj.

Shembuj: të dhënat tuaja të identifikimit, numri i sigurimeve shoqërore, fotoja e pasaportës



Karakteristikat

Informacioni tipik ose i dallueshëm që lidhet me ju dhe që ju dallon nga personat e tjerë.

Shembuj: nënshkrimi juaj si provë e dorëzimit



Të dhënat e telekomunikacionit dhe të anketimit

Informacioni që ju i komunikoni njërit prej punonjësve tanë apo që jepni përmes plotësimit të një ankete në internet, p.sh. kur telefononi shërbimin tonë të klientit.

Shembuj: përshtypjet tuaja, regjistrimi i telefonatës (sipas rastit)



Përse i mbledhim të dhënat tuaja

Në DHL Express, ne i përpunojmë të dhënat tuaja vetëm për qëllime specifike dhe kur kemi baza ligjore për ta bërë këtë. Kjo mund të bëhet për një nga arsyet e mëposhtme:

- Për përmbushjen e një kontrate kur ndërmerrni hapa për të lidhur një kontratë me ne.
- Për të përmbushur një detyrim ligjor.
- Për qëllime të ndjekjes së interesave legjitime dhe për të mbrojtur të drejtat tuaja dhe tonat, p.sh. për të rritur nivelin e kënaqshmërisë suaj si klient, për të ofruar dhe për të përmirësuar shërbimet që ne ofrojmë për ju, për të lehtësuar komunikimin dhe ndërveprimin tuaj me ne, për t'ju ofruar një shërbim më efikas, të thjeshtuar dhe me kosto efektive, për të menaxhuar më mirë marrëdhënien tonë me ju dhe mundësitë që paraqet kjo marrëdhënie, për të optimizuar itineraret tona, për t'i mbrojtur më mirë të dhënat tuaja dhe për t'u siguruar që në rrjetin tonë të mos hyjnë artikuj të ndaluar dhe të palejueshëm. Ne do të sigurohemi që këto interesa legjitime të balancohen. Kur është e mundur, ju keni të drejtën të kundërshtoni.
- Mbi bazën e pëlqimit tuaj, të cilin ju mund ta tërhiqni në çdo kohë.

Më poshtë janë renditur qëllimet për të cilat ne përpunojmë të dhënat tuaja.

Qëllimi

Baza e ligjshme për përpunimin

Për ju si klient

Për të ofruar produktet dhe shërbimet tona, duke përfshirë

Për tërheqjen dhe dorëzimin e dërgesës suaj	Përmbushja e një kontrate
Për të menaxhuar dërgesën tuaj në rrjetin tonë global	Përmbushja e një kontrate
Për të respektuar të gjitha rregulloret e importit dhe eksportit	Përmbushja e një kontrate Një detyrim ligjor
Për t'ju identifikuar	Përmbushja e një kontrate Një detyrim ligjor Një interes legjitim Pëlqimi
Për t'ju ndihmuar të përdorni mjetet tona	Përmbushja e një kontrate
Për t'i lejuar partnerët tanë të biznesit që t'ju shërbejnë	Përmbushja e një kontrate Një interes legjitim Pëlqimi
Për të përpunuar të dhënat financiare nga ju	Përmbushja e një kontrate
Për të menaxhuar marrëdhënien tonë me ju, duke përfshirë	
Për të përmirësuar përvojën tuaj me DHL dhe produktet e shërbimet tona, p.sh. evenimentet, lotaritë, anketat	Përmbushja e një kontrate Një interes legjitim Pëlqimi
Për t'ju mbajtur të përditësuar rreth produkteve dhe shërbimeve tona që mund t'ju interesojnë	Një interes legjitim Pëlqimi
Për të zgjeruar produktet dhe shërbimet tona	Përmbushja e një kontrate Një interes legjitim Pëlqimi
Për t'ju lehtësuar vizitën në faqen tonë në internet	Pëlqimi
Për t'ju integruar si klient i ri	Përmbushja e një kontrate Një interes legjitim
Për të komunikuar me ju	Përmbushja e një kontrate Një interes legjitim

Për ju si partner biznesi

Për të na ofruar shërbime, duke përfshirë

Për të menaxhuar marrëdhënien tonë me ju	Përmbushja e një kontrate Një interes legjitim
Për të marrë shërbime prej jush	Përmbushja e një kontrate Një interes legjitim

Për ju si kandidat

Për t'ju mirëpritur të na bashkoheni, duke përfshirë

Për t'ju regjistruar si kandidat, p.sh në panairë pune	Përmbushja e një kontrate Një interes legjitim
--	---

Për të verifikuar kualifikueshmërinë tuaj	Përmbushja e një kontrate Një interes legjitim
Për t'ju integruar	Përmbushja e një kontrate
Për t'ju mbajtur në listën tonë të kandidatëve rezervë	Pëlqimi

Për çdokënd

Për të mbrojtur dhe siguruar të dhënat tuaja, duke përfshirë

Për të garantuar sigurinë e rrjeteve dhe sistemeve tona të informacionit	Një detyrim ligjor Një interes legjitim
Për t'ju mbrojtur	Një detyrim ligjor Një interes legjitim



Vizitimi i faqes sonë në internet

Kur vizitoni faqet tona në internet, ne ruajmë të dhënat tuaja që na nevojiten për ta bërë faqen të aksesueshme për ju (p.sh. adresa e IP-së, data dhe kohëzgjatja e vizitës suaj). Më pas, ne i ruajmë ato në skedarët e evidencës për të garantuar funksionalitetin e faqeve tona në internet dhe sigurinë e sistemeve tona. Për rrjedhojë, ne kemi një interes legjitim në përpunimin e të dhënave tuaja. Ne i fshijmë të dhënat tuaja menjëherë kur ato nuk nevojiten më për arritjen e qëllimit për të cilin janë mbledhur.



Ekzaminimi i dërgesave

Dërgesat ekzaminohen për të verifikuar përmbajtjen e tyre, për të përshtatur përshkrimin e detajuar, për të konfirmuar vlerën e tyre dhe për të respektuar ligjet në fuqi dhe Kushtet tona të Transportit. Ne i ekzaminojmë të gjitha dërgesat për qëllime sigurie, për të shmangur hyrjen e artikujve të ndaluar dhe të palejueshëm në sistemin tonë ose për të zbuluar veprat penale ose keqpërdorimet. Ne kemi një interes legjitim në kryerjen e këtij përpunimi, pasi ai garanton mbarëvajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të produkteve tona në favorin tuaj.



Përrjashtimet e dërgesave

Në DHL, ne përpiqemi t'i dorëzojmë dërgesat tuaja me kujdesin maksimal dhe pa vonesa të paarsyeshme. Nëse ne nuk mund ta dorëzojmë dërgesën tuaj, ajo do t'i rikthehet dërguesit. Për shembull, kur nuk mund të gjendet asnjë adresë, dërgesa do të trajtohet në Qendrën e DHL për Dërgesat e Gjetura. Ne mund ta hapim dërgesën tuaj për të identifikuar adresën e kthimit apo të dorëzimit. Për rrjedhojë, ne kemi interes legjitim për të përpunuar të dhënat tuaja.



Ekzaminimi i Palëve të Ndaluar

Palët e Ndaluar janë individë ose subjekte që janë përfshirë në një listë të personave të ndaluar nga një autoritet rregullator, duke i ndaluar të marrin pjesë të transaksione importi apo eksporti, apo që janë sanksionuar nga një autoritet rregullator për veprime të

jashtëligjshme, si përfshirja në terrorizëm, në trafikimin e lëndëve narkotike, në pastrimin e parave apo në përhapjen e armëve. Dërgesat për apo nga Palët e Ndaluar nuk lejohen.

Çdo dërgesë në rrjetin e DHL Express ekzaminohet me qëllim zbulimin e Palëve të Ndaluar. Dërgesat për ose nga Palët potencialisht të Ndaluar mund të mbahen për ekzaminim të mëtejshëm për të verifikuar se dërgesa nuk është e ndaluar. Për të lehtësuar zhbllokimin e shpejtë të dërgesës, ne mund të kërkojmë një kopje të dokumentit tuaj të identifikimit.

Bazuar në interesin tuaj legjitim dhe në atë të DHL Express, ne do t'i përpunojmë të dhënat tuaja dhe mund t'i mbajmë të dhënat që janë domosdoshmërisht të nevojshme për një periudhë të kufizuar. Kjo parandalon vonesat e shkaktuara nga procesi i ekzaminimit për dërgesat tuaja të ardhshme. Megjithatë, ju keni të drejtën të kundërshtoni verbalisht ose me shkrim.

Nëse keni pyetje lidhur me rregulloret, sanksionet tregtare dhe Palët e Ndaluar, vizitoni faqet në internet të autoriteteve përkatëse, p.sh. Organizata e Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe qeveria e SHBA-së.



Telefonatat dhe regjistrimet e telefonatave

Në raste të caktuara, DHL do t'ju telefonojë për t'ju sqaruar mbi çështjet kontraktuale, për të marrë përshtypjet tuaja ose për qëllime marketingu. Baza ligjore për këtë është përmbushja e një kontrate, interesi legjitim ose pëlqimi. Për shembull, në disa vende, telefonatat për qëllime marketingu kryhen vetëm me pëlqimin tuaj paraprak.

Nëse ju na telefononi ose merrni një telefonatë nga ne, kjo telefonatë mund të regjistrohet për çështje që lidhen me dërgesën ose për qëllime trajnimi dhe të sigurimit të cilësisë. Ne do ta trajtojmë regjistrimin e telefonatës suaj në përputhje me ligjet në fuqi për mbrojtjen e të dhënave dhe telekomunikacionin. Kur regjistrimi i telefonatës bëhet në bazë të pëlqimit, telefonata do të regjistrohet vetëm pasi të jepni pëlqimin tuaj. Ju mund ta tërhiqni pëlqimin tuaj në çdo kohë. Nga ky moment e në vazhdim, asnjë komunikim nuk do të regjistrohet më. Në vendet ku regjistrimi i telefonatave është i kushtëzuar nga interesi legjitim, ju mund ta kundërshtoni regjistrimin.



Përshtypjet e klientëve

DHL mund të ndërveprojë me ju për të marrë përshtypjet tuaja dhe për t'u informuar rreth përvojës suaj me ne. Përgjigjia juaj do të na ndihmojë të bëjmë përmirësime në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve tona. Në disa vende, ne e nënkontraktojmë këtë proces te një partner biznesi. Në varësi të shtetit ku ndodheni, përpunimi do të bazohet tek interesi legjitim apo te pëlqimi juaj.



Zhdoganimi

Ne dëshirojmë të sigurohemi që dërgesa juaj të arrijë sa më shpejt, duke lehtësuar procesin e zhdoganimit për ju. Për këtë qëllim, është e nevojshme që të na jepni të gjithë dokumentacionin që kërkohet për zhdoganimin. Duke qenë se procedurat doganore variojnë sipas shteteve, mund të zbatohen kërkesa ligjore të ndryshme. Për shembull, në disa vende, autoritetet doganore kërkojnë numrin e sigurimeve shoqërore, kartën e identitetit ose një kopje të pasaportës për të bërë zhdoganimin e ngarkesës. Për të qenë në pajtueshmëri me rregulloret doganore dhe për të përmbushur detyrimet tona kontraktuale, nevojitet përpunimi i të dhënave tuaja. Në rastet kur ne i ruajmë të dhënat tuaja për dërgesat e ardhshme, ju keni të drejtën të kundërshtoni.



Mesazhet dixhitale

Për të lehtësuar komunikimin mes nesh, ne ju ofrojmë të na kontaktoni përmes secilit prej kanaleve të komunikimit të palëve të treta që ju preferoni (p.sh. Facebook dhe Asistenti Virtual i DHL). Sistemet përgjigjen me fjalë kyçe ose ia kalojnë kërkesën tuaj një anëtar të stafit në një bisedë të drejtpërdrejtë. Kjo është një mënyrë e shpejtë dhe e lehtë për të marrë përgjigje mbi statusin e dërgesave tuaja apo mbi produktet dhe shërbimet tona. DHL ka një interes legjitim për të përpunuar të dhënat tuaja për lehtësimin e komunikimeve tona. Nëse nuk dëshironi ta përdorni këtë kanal, jeni të mirëpritur të kontaktoni shërbimin tonë të klientit. Për informacione të mëtejshme mbi praktikën e mbrojtjes së të dhënave që përdorin ofruesit e kanaleve të komunikimit, vizitoni faqet e tyre në internet.



Kukit dhe teknologjitë e ngjashme

DHL përdor teknologji të ndryshme për të ruajtur preferencat tuaja të përdoruesit apo informacione të tjera, me qëllimin për t'i bërë shërbimet që ofrojmë për ju sa më të përshtatshme dhe efikase. Kur aksesoni faqen tonë në internet, një Qendër e Preferencave të Privatësisë do t'ju informojë se kërkohet pëlqimi juaj për përdorimin e kukive të caktuara, siç janë kukit analitike ose teknologji të ngjashme.



Vendndodhja gjeografike

DHL do të mbledhë informacion mbi vendndodhjen tuaj drejtpërdrejt nga ju. Ne ju ofrojmë një përvojë më të mirë përdoruesi në sistemet tona, në sajë të integritetit të sistemeve të hartëzimit (p.sh. Google Maps, Microsoft Bing Maps...). Këto mund të përdoren për gjurmimin e dërgesave, kërkimin e vendndodhjes dhe dorëzimin në Pikat e Shërbimit të DHL në rast se keni zgjedhur ridrejtimin e dërgesës suaj. Në varësi të shtetit ku ndodhni, ky përpunim mund të bazohet tek interesi legjitim ose te pëlqimi juaj.



Survejimi me video "CCTV"

DHL ka instaluar kamera për survejim me video për të kontrolluar aksesin në godinat tona dhe në hapësira specifike si parkingjet, si dhe për të mbikëqyrur operacionet tona të biznesit. Survejimi me video përdoret për të garantuar shëndetin dhe sigurinë e vizitorëve, personelit

dhe pronës sonë, si dhe për të monitoruar proceset operacionale në ambientet tona. Prandaj, ne kemi një interes legjitim për qëllime të sigurisë dhe kontrollit të aksesit, i cili është i nevojshëm për menaxhimin e godinave të DHL.



Faqet e dashamirësve në mediat sociale

Ne ju ofrojmë faqet tona të dashamirësve në mediat sociale si Facebook, Instagram ose LinkedIn për të menaxhuar më mirë marrëdhënien tonë me ju dhe për të komunikuar me ju. Për rrjedhojë, ne kemi interes legjitim për të përpunuar të dhënat tuaja. Për më tepër informacion, vizitoni Njoftimet tona për Privatësinë në faqet tona të dashamirësve në mediat sociale.



Pikat e Shërbimit të DHL

Ju mund të dërgoni dhe të merrni pako përmes Pikave të Shërbimit. Këto Pika Shërbimi mund të jenë në pronësi të DHL-së ose të një partneri biznesi palë e tretë (p.sh. pika e shitjes së gazetave më pranë jush). Nëse zgjidhni të operoni përmes një Pike Shërbimi, DHL do të përpunojë vetëm të dhënat minimale që janë domosdoshmërisht të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve tona kontraktuale kundrejt jush. Kjo mund të përfshijë dorëzimin e pakos suaj të Pika juaj e preferuar e Shërbimit ose dërgimin e pakove tuaja të marrësi juaj i synuar.



Partnerët e pagesave

DHL ju ofron disa opsione pagese për të përmirësuar përvojën tuaj me pagesat. Ne pranojmë të gjitha kartat kryesore të debitit dhe të kreditit, si dhe sistemet e pagesave në internet. Të dhënat tuaja të pagesës do të përpunohen në përputhje me standardet e përpunimit të industrisë së pagesave për të ofruar shërbimin që ju kërkoni dhe për të përmbushur detyrimet tona kontraktuale.



Si i mbledhim të dhënat tuaja

Ne i mbledhim dhe i përdorim të dhënat tuaja kryesisht për tërheqjen, transportin dhe dorëzimin e dërgesës suaj.

Ne mund t'i mbledhim të dhënat tuaja në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Kur ju ndani në mënyrë aktive informacione me ne, p.sh. duke krijuar një llogari, duke na kontaktuar ose duke plotësuar një formular në faqen tonë në internet ose një anketë, ne i marrim të dhënat tona drejtpërdrejt nga ju. Kur ne i marrim të dhënat tuaja nga një palë e tretë e jashtme (p.sh. nga dërguesi), konsiderohet se i kemi marrë këto të dhëna në mënyrë të tërthortë. Në këtë rast, është përgjegjësi e ofruesit të të dhënave që të sigurojë saktësinë e të dhënave dhe t'i transferojë ato te ne në përputhje me legjislacionin në fuqi.



Informacioni për partnerët tanë të biznesit

Ne përpunojmë të dhëna për ju si partneri ynë i biznesit, me qëllimin për të menaxhuar kontratat tona me ju ose për të marrë shërbime nga ju.

Ne mbledhim vetëm të dhënat që janë të nevojshme për qëllimet tona kontraktuale të rena dakord dhe do t'i ndajmë të dhënat vetëm në përputhje me ligjet në fuqi për mbrojtjen e të dhënave dhe vetëm për qëllimet e rena dakord.

Ne i përdorim shërbimet tuaja për t'u shërbyer më mirë punonjësve dhe klientëve tanë. Kjo i mundëson DHL të garantojë afërsi me klientët tanë për tërheqjet dhe dorëzimet e tyre, shërbime të menaxhimit të të dhënave të dërgesës, partnerë për sigurinë dhe mbrojtjen, audite, ofrues pagesash dhe hostim TI.



Për sa kohë i ruajmë të dhënat tuaja

Ne do t'i ruajmë të dhënat tuaja për sa kohë që kjo është e nevojshme për përmbushjen e qëllimeve tona, për realizimin e kontratave tona dhe për përmbushjen e çdo detyrimi ligjor. Periudha e ruajtjes mund të variojë sipas shtetit, bazuar në ligjet vendase në fuqi.

Për të përmbushur detyrimet ligjore përkatëse, ne do t'i ruajmë disa prej të dhënave tuaja për një periudhë deri në 11 vite. Kjo periudhë varion sipas shtetit, në bazë të përcaktimit në ligjet vendase në fuqi. Për shembull, ruajtja e dokumenteve të dërgesës që nevojiten për përpunimin e dërgesës. Ne përcaktojmë një periudhë ruajtjeje të përshtatshme dhe të arsyeshme, duke marrë në konsideratë natyrën, sensitivitetin dhe domosdoshmërinë e të dhënave tuaja.

Ne përpiqemi vazhdimisht të minimizojmë periudhën e ruajtjes së të dhënave kur kjo është në përputhje me qëllimin, ligjin ose kontratat. Për shembull, në disa shtete, të dhënat për qëllime të kënaqshmërisë së klientëve ruhen për jo më gjatë se 3 vite. Të dhënat që ne mbledhim në bazë të pëlqimit tuaj do të përpunohen derisa ju të tërhiqni pëlqimin tuaj.



Si e garantojmë sigurinë e të dhënave tuaja

DHL e merr mjaft seriozisht sigurinë e të dhënave tuaja. Ne kemi vënë në zbatim një sërë strategjish, kontrollesh, politikash dhe masash për të ruajtur sigurinë e të dhënave tuaja. Ne bëjmë vazhdimisht rishikimin e imtësishëm të masave tona të sigurisë. Ne përdorim masa mbrojtëse të tilla si muret mbrojtëse, sistemet e ndërhyrjes në rrjet dhe monitorimi i aplikacioneve. Kur është e përshtatshme, ne i sigurojmë të dhënat tuaja duke përdorur teknikat e pseudonimizimit dhe të enkriptimit gjatë ruajtjes dhe transferimit të të dhënave tuaja. Ne sigurohemi që të ketë kontrolle të rrepta të aksesit fizik në godinat tona dhe në qendrat e certifikuara të të dhënave.

Si pjesë e strategjisë sonë të sigurisë, kemi ngritur programe auditimi për t'u siguruar që sistemet dhe shërbimet tona të jenë në përputhje me politikën e DPDHL për sigurinë e informacionit, dhe rrjedhimisht me standardin ISO 27001.

Gjithashtu, ne jemi duke marrë një sërë masash të vazhdueshme për reduktimin e rrezikut, duke përfshirë (pa kufizim) trajnimin e punonjësve tanë dhe organizimin e ushtrimeve me simulim incidentesh nga Qendra jonë e Mbrojtjes Kibernetike.

Qëllimi është të kemi një operim të vazhdueshëm të sistemit TI dhe të parandalojmë aksesin e paautorizuar.



A do të transferohen të dhënat tuaja

DHL do t'i ndajë ose transferojë të dhënat tuaja në kuadër të përmbushjes së qëllimeve të parashtruara në këtë Njoftim për Privatësinë, kur kjo lejohet nga legjislacioni në fuqi dhe me masat e duhura mbrojtëse.

Në do t'i transferojmë të dhënat tuaja te kategoritë e mëposhtme të marrësve:

- Shoqëritë e Grupit DPDHL: transferimi kërkohet brenda DPDHL për të ofruar dhe përmirësuar produktet dhe shërbimet tona. Transferimet mund të kryhen gjithashtu për të menaxhuar marrëdhënien tonë me ju, për t'ju identifikuar dhe për të respektuar të drejtat tuaja të privatësisë
- Partnerët e biznesit: transferimi kufizohet vetëm në të dhënat e nevojshme (p.sh. për të tërhequr ose dorëzuar pakon tuaj në një Pikë Shërbimi, në disa zona për të bërë tërheqjen dhe dorëzimin ose për të kryer zhdoganimin.)
- Autoritetet publike: transferimi kërkohet nga legjislacioni në fuqi (p.sh. për të përmbushur një detyrim ligjor gjatë përpunimit të dërgesës)

Të dhënat tuaja transferohen jashtë Zonës Ekonomike Evropiane (ZEE) te shoqëri të tjera të Deutsche Post DHL Group, te partnerë biznesi palë të treta ose tek autoritetet publike vetëm kur kjo lejohet nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave. Në këto raste, ne do të sigurohemi që të merren masat e duhura të sigurisë për të garantuar transferimin e të dhënave tuaja (p.sh. rregullat detyruese të korporatës sonë, klauzolat kontraktuale standarde).

[Politika për Privatësinë e të Dhënave e DPDHL](#) rregullon standardet tona në nivel grupi për përpunimin e të dhënave tuaja.



Ne respektojmë të drejtat tuaja

Sipas rastit, ligjet për mbrojtjen e të dhënave parashikojnë disa të drejta që mund të ushtrohen nga ju:

E drejta për akses në informacion

Ju keni të drejtën të viheni në dijeni të informacionit që ne mbajmë rreth jush.

Kjo përfshin të drejtën për të na kërkuar informacion shtesë lidhur me kategoritë e të dhënave tuaja që ne po përpunojmë, qëllimin për të cilin ato po përpunohen, kategoritë e partnerëve

të biznesit të cilët mund të dërgohen të dhënat dhe të drejtat tuaja të tjera në lidhje me përdorimin e të dhënave tuaja prej nesh.

Ne do t'ju japim këtë informacion brenda një muaji pas kërkesës suaj, për sa kohë që kjo nuk cenon të drejtat dhe liritë e një personi tjetër.

E drejta për korrigjim

Ju keni të drejtën të kërkonti korrigjim të pasaktësive në të dhënat tuaja personale.

E drejta për të kundërshtuar

Ju keni të drejtën të kundërshtoni lloje të caktuara të përpunimit që bazohen tek interesi legjitim, siç është marketingu i drejtpërdrejtë.

E drejta për të tërhequr pëlqimin tuaj

Ju keni të drejtën ta tërhiqni pëlqimin tuaj në çdo kohë.

E drejta e transferueshmërisë

Ju keni të drejtën t'i transferoni të dhënat tuaja te një kontrollues tjetër. Ne do t'ju japim një format të eksportuar të të dhënave që na keni dhënë.

E drejta e fshirjes

Ju keni të drejtën që, në rrethana të caktuara, të kërkonti fshirjen e të dhënave tuaja. Kur e drejta juaj për fshirje është e vlefshme, dhe vetëm nëse kjo është e nevojshme, mund të ruhen të dhëna minimale rreth jush për të siguruar që të mos kontaktoheni sërish. Nëse i përdorni shërbimet tona sërish, ju do të trajtoheni si klient i ri.

E drejta e kufizimit të përpunimit

Ju keni të drejtën të kërkonti kufizim të mënyrës së përdorimit të të dhënave tuaja.

E drejta që lidhet me vendimmarrjen automatike, duke përfshirë profilizimin

Ju keni të drejtën të kërkonti një rishikim të përpunimit të automatizuar. Në këtë moment, DHL nuk merr asnjë vendim të automatizuar me pasoja ligjore për ju. Në rast se DHL merr vendime të tilla në të ardhmen, kjo do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kërkesat që lidhen me të drejtat e mësipërme apo pyetjet e tjera në lidhje me këtë Njoftim për Privatësinë mund t'ia drejtoni Nëpunësit tonë përgjegjës për Mbrojtjen e të Dhënave në shtetin ku ju banoni. DHL nuk mund ta trajtojë kërkesën tuaj pa u siguruar siç duhet për identitetin tuaj. Vini re se legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave mund të vendosë kushte për ushtrimin e të drejtave të mësipërme.



Kërkesat dhe ankesat

Ne do t'i trajtojmë të gjitha kërkesat tuaja me kujdesin që ato meritojnë. Nëse nuk arrijmë t'ju japim një përgjigje të kënaqshme, [na kontaktoni](#).

Nëse nuk arrijmë t'i trajtojmë shqetësimet tuaja, mund të dërgoni një ankesë pranë Autoritetit tuaj lokal të Mbrojtjes së të Dhënave.

 Fjalorth

Partnerët e biznesit	Palët e treta që na ofrojnë shërbime
Ofruesit e kanaleve të komunikimit	Palët e treta që na ofrojnë përdorimin e kanaleve të tyre të komunikimit
Kontrolluesi	Kontrolluesi i të dhënave përcakton qëllimin/qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale
Të dhënat	Të gjitha të dhënat personale në lidhje me një person që mund të identifikohet apo mund të jetë i identifikueshëm në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë
DHL Express	DHL, ne, neve, i joni/e jona
DPO	DPO sigurohet për respektimin e rregullave të mbrojtjes së të dhënave brenda shoqërisë
Përpunuesi	Përpunuesi i të dhënave përpunon të dhëna personale vetëm për llogari të kontrolluesit
Marrësit e dërgesave	Pala së cilës i dorëzohet dërgesa, p.sh. vetë marrësi, fqinjët e tij
Dërguesit	Pala që nis një dërgesë nga njëra vendndodhje në tjetrën nëpërmjet nesh